

përmbajtja

- 2 Gratë Veprojnë: Ndërtimi i Paqes në Ballkan
- 2 Mundësitë e Rrjetit të Grave RAE
- 2 Takimi i Prillit
- 3 Shoqëria Civile dhe Qeveria Bashkëpunojnë
- 3 KGP Harton Planet e Ardhshme
- 3 Diplomojnë 20 Këshilltarë Psikosocial
- 4 Vazhdon Fushata Kundër Kancerit të Gjirit
- 4 Trajtimi i Personave të Traumatizuar
- 4 Njoftim i Shkurtër

njohtimet

Takimi i RrGGK.....
.....**Hani i Dy Robertëve**
4 Qershor, ora 11
Prishtinë

**RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS**



**KOSOVA WOMENS
NETWORK**

www.womensnetwork.org

Zëri i

Gruas Kosovare

Kosova: rruga e saj drejtë pavarësisë!

Të nderuara anëtare dhe miq të Rrjetit,

Përmes këtij numri të buletinit, desha të ju informoj për dy ngjarje të rëndësishme në të cilat isha e ftuar si folëse gjatë muajit maj. E para, është konferenca në Berlin (4-6 maj) me temën: Roadmap to 1325: Perspektiva Gjimore në Unionin Europian (UE)

Ditën e parë të konferencës, fola për përvojën që kishim me UNMIK-un në Kosovë dhe mënyrën se si ata nuk e kanë implementuar RKS1325 të KB dhe në fund i dhashë rekomandimet për misionin e ardhshëm të misionit të UE në Kosovë.

Pas dite, në të njejtën ditë u organizua punëtorja për Kosovën dhe duke falenderuar edhe Flora Maculen (UNIFEM), e cila dha kontribut të madh gjatë punëtorisë dhe falë kësaj dy pjesëmarrëse të rëndësishme, njëra, Anamaria Gomes, parlamentare në UE dhe tjetra, Nicole Reckinger, nga Këshilli i Europës premtuan se do të ftojë një delegacion të grave Kosovare në parlamentin e Europës dhe se do të aplikojnë rekomandimet tona në misionin e UE në Kosovë.

Ndërsa me 7 maj isha e ftuar si folëse në seminarin e organizuar nga SIDA në Suedi me temën: Kosova: rruga e saj drejtë pavarësisë!

Në pjesën e parë të seminarit, z. Marti Ahtisaari foli për propozimin e tij për Statusin e ardhshëm të Kosovës. Unë kisha prezantimin në pjesën e dytë të seminarit.

Në mesin e të pranishmëve ishin edhe ambasadori i Rusisë, Serbisë dhe Shqipërisë, nga Ministria e Jashtme e Suedisë, SIDA, dhe organizata tjera suedeze, diaspora Serbe në Suedi dhe disa nga diaspora Kosovare.

Gjatë prezantimit tim, mes tjerash përmenda përpjekjet tona për integrimin e serbeve në Kosovë, për manipulimin e tyre nga Beogradi dhe planin i tyre për mosintegrimin e Serbëve duke u dhënë shembullin se si përfaqësuesja në delegacionin Serb saherë që ka vizituar Serbët e Kosovës u ka urdhëruar të mos bashkëpunojnë me Shqiptarët.

Poashtu përmenda aktivitetet që kemi pas përmes Koalicionit të Grave për Paqe.

Dhe përfundova me fjalët:

"Bregosem për aktivistet që punojnë për paqe në Serbi sepse ato janë të kërcënuara çdo ditë nga Qeveria Serbe për shkak se ato publikisht kanë përkrahur pavarësinë e Kosovës përmes kumtesave të shumta. Prandaj rekomandojë që Ministria e Jashtme e Suedisë të reagojë në mbrojtjen e sigurisë së këtyre aktivisteve në Serbi.

Sinqerisht,
Igballe Rogova



**Igballe Rogova
gjatë fjalimit në
seminarin "Kosova:
rruga e saj drejtë Pavarësisë!", në
Stockholm.**



z. Marti Ahtisaari gjatë fjalimit të tij për propozimin e tij për Statusin e Ardhshëm të Kosovës, me 7 maj, në Stockholm.

Shënime nga Takimi i Prillit

Gjatë Majit do të organizohen takime me grupet punuese të tri strategjive të vendosura si prioritet i aktiviteteve të Rrjetit për vitin 2007: Shëndeti i gruas; Fuqizimi i grave në politikë dhe vendimmarrje; dhe Trafikimi i grave dhe vajzave.

Me 23 Mars, grupi joformal i deputeteve të Kosovës ka ftuar përfaqësueset e Rrjetit në tryezën e rrumbullakët, me temën "Gruaja dhe zgjedhjet". Në këtë tryezë u diskutua për mënyrat bashkëpunimin në mes grave në politikë dhe grave në shoqërinë civile dhe për ligjin e zgjedhjeve.

Rrjeti së bashku me anëtarët e veta, gjatë muajve të ardhshëm do të organizojë takime me gratë Serbe nëpër komunat ku jeton komuniteti Serb.

OJQ "Femrat në Veprim" nga Kaçaniku ka filluar sërish aktivitetet e saj, dhe është riantarësuar në RrGGK.

UNFPA bënë prezentimin e raportit "Shtatzënia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë", që flet për abortin në Kosovë dhe është i përkthyer edhe në gjuhën serbe dhe në anglisht.

Prej qershorit, ekipi monitorues për Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësitë do të dal në teren për të parë se si po implementohet Kodi nëpër organizatat anëtare.

IOM njoftoi për organizimin e debateve televizive dhe shfaqjen e filmit "Rekrutimi" mbi trafikimin e vajzave. Poashtu njohtuan anëtarët për organizimin e mbledhjes së Rrjetit Rajonal të organizatave që punojnë në fushën kundër trafikimit, në Shkup.

Qendra për Trajtime dhe Studime Gjinore në Prishtinë, me 2 - 3 prill, organizoi trajnimin "Dhuna në Familje dhe Shëndeti i Gruas".

Gratë Veprojnë: Ndërtimi i Paqes në Ballkan

Me 19 prill në Vjenë u mbledhën gratë politike dhe përfaqësueset e shoqërisë civile nga Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Kosova për takimin "Samiti i Grave për Paqe të Qëndrueshme në Evropën Jug Lindore".

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi situatën politike të vendeve që ato përfaqësojnë dhe për atë se si ato mund të shtojnë dukshmërinë dhe ndikimin e kontributit të grave drejt sigurimit të një zgjidhjeje paqësore dhe të zbatueshme për zgjidhjen e konflikteve politike në rajon.

Poashtu ditën e parë, nga Komisioni Kombëtar i Austrisë për UNIFEM-in dhe Forumi për Bashkëbisedimet Ndërkombëtare Bruno Kriesky, u organizua tryeza e rrumbullakët me temën "Gratë Veprojnë: Ndërtimi i Paqes në Ballkan".

Ditën e dytë u ndanë në grupe punuese për të analizuar dhe finalizuar strategjitë



Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore gjatë takimit në Vjenë me 19 prill 2007.

e punës për vitin 2007.

Lobi Rajonal i Grave dërgoi një deklaratë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në deklaratë mes tjerash thuhej se: "Lobi shpreh mbështetjen e përzemërt për propozimin e Ahtisarit për statusin e ardhshëm të Kosovës; Lobi inkurajon Këshillin e Sigurimit që të garantojë se rezoluta e re për Kosovën njihet të drejtën për siguri humanitare për të gjitha femrat dhe meshkujt si gur themel për paqen e qëndrueshme në Kosovë dhe rajon; Lobi i

mirëpret standardet e larta të vendosura nga propozimi i z.Ahtisaari për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha bashkësive etnike dhe fetare dhe integrimin e tyre të plotë në shoqërinë kosovare; dhe se Lobi Rajonal i Grave e njihet të drejtën e qytetarëve të zhvendosur që të kthehen në Kosovë sikur edhe obligimin e Qeverisë së Kosovës që të mbështes integrimin e tyre". Takimi i Lobit u përkrah nga UNIFEM dhe UNDEF.

Mundësitë e Rrjetit të Grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptase

Në dhjetor të vitit 2006 filloi realizimi i projektit të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore për Mundësitë e Rrjetit të Grave RAE që do të zgjas deri në nëntor të vitit 2007.

Qëllimi i këtij projekti është ngritja dhe fuqizimi i një rrjeti të qëndrueshëm dhe afatgjatë të grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptase për punën strategjike dhe koordinimin e pavarur të tyre në të ardhmen që është menduar të bëhet përmes shkëmbimit të përvojave, trajnimeve për studime gjinore dhe vlerësimit të nevojave të këtyre komuniteteve.

Me 21 dhjetor 2006, u mbajt edhe mbledhja e parë me organizatat e komunitetit

Rom, Ashkali dhe Egjiptase ku u prezantua projekti duke theksuar qëllimet dhe aktivitetet e tij. Këtë iniciativë e përshëndetën drejtoresha ekzekutive e QKSGJ, Luljeta Vuniqi, dhe Flora Macula, udhëheqëse e Zyrës së UNIFEM-it në Prishtinë, njëherësh edhe donatore e projektit.

Në mbledhjen e dytë të këtij rrjeti mes tjerash u vendos edhe për emrin zyrtar që do të jetë Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës.

Në prill u QKSGJ organizoi një vizitë tre ditore në Maqedoni, mes një grupi të Rrjetit RAE dhe OJQ-ve grave Rome në Maqedoni, me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe përvojës të

organizatave rome në Maqedoni.

Poashtu në maj të këtij viti u organizua mbledhja e parë e rrjetit RAE me donatorë. Qëllimi i mbledhjes ishte njohja e donatorëve me rrjetin RAE, mbledhje kjo që përfundoi me sukses dhe me mundësi bashkëpunimi në të ardhmen në mes të këtyre organizatave dhe Rrjetit RAE.

QKSGJ do të ofrojë përkrahje të plotë gjatë të gjitha aktiviteteve të Rrjetit RAE.

Shoqëria Civile dhe Qeveria Vazhdojnë Bashkëpunimin

Në vazhden e bashkëpunimit të RrGGK dhe institucioneve qeveritare gjatë muajve të kaluar u zhvilluan disa aktivitete. Në muajin prill Agjencioni për Barazi Gjinore i Zyrës së Kryeministrit mbajti një takim ku prezantoi Memorandumin e Mirëkuptimit.

Ky dokument do të zyrtarizoj bashkëpunimin e OJQ-ve dhe Agjencionit dhe do të vë baza për të drejtat dhe obligimet që kanë si Agjencioni ashtu edhe OJQ-të gjatë bashkëpunimit të ndërsjellë.

Me 24 maj RrGGK nënshkroi këtë dokument i cili do të pas-

het nga nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit ku do të konkretizohen fushat e bashkëpunimit mes RrGGK dhe Agjencionit.

Gjatë kësaj faze vazhduan takimet e përfaqësueseve të RrGGK dhe Grupit Joformal të Deputeteve të Kuvendit të Kosovës si dhe pjesëmarrja e përfaqësueseve të RrGGK në takimet e organizuara mes qeveritarëve dhe OJQ-ve.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve të vazhdueshme nga ana e përfaqësueseve të RrGGK, Ministresha e Shërbimeve Publike publikisht njohu dhe

përkrahu rolin e organizatave të shoqërisë civile e sidomos të grave aktiviste.

Zyrtarët e Ministrisë së Shërbimeve Publike nxorën në muajin maj Udhëzimin Administrativ Nr, 2007/03 për arritjen e barazisë gjinore në institucionet e administratës publike.

Ky udhëzim flet për vendosmërinë e institucioneve qeveritare për përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë kosovare dhe si i tillë është shumë i mirëpritur nga RrGGK.

Koalicioni i Grave për Paqe Harton Planet e Ardhshme

Me 29 Mars, në zyrën e Rrjetit në Prishtinë, u mbajt takimi me grupin strategjik të Koalicionit të Grave për Paqe (KGP).

Në pjesën e parë të këtij takimi u diskutua për aktivitetet e kaluara të KGP, si dhe për ndryshimet politike në Kosovë dhe Serbi dhe për ndikimin e këtyre ndryshimeve në shoqërinë civile në vendet gjegjëse.

Në vazhdim u cekën edhe planet dhe aktivitetet e Koalicionit për këtë vit që do të jenë: takimet koordinuese të KGP, materialet promovuese të KGP, si dhe një dokumentar që do të realizohet në të ardhmen

për aktivitetet e Koalicionit të Grave për Paqe. Nga të gjitha pjesëmarrëset u theksua rëndësia e veçantë e rrjetëzimeve horizontal në mes të organizatave anëtareve të Rrjetit të Grave të Kosovës dhe Grave në të Zeza nga Srebia.

Bazuar në këtë u vendos që kjo të jetë njëra ndër temat kryesore të konferencës së dytë të KGP që do të mbahet në shtator të këtij viti.

Në vazhdimësi të aktiviteteve avokuese të KGP në nivelin ndërkombëtar u planifikua pjesëmarrja e dy anëtareve në konferencën në Oxford në qershor si dhe

pjesëmarrja e përfaqësueseve të KGP në konferencën e ardhshme të Rrjetëzimit Ndërkombëtar të Grave në të Zeza që do të organizohet në Spanjë, në gusht, 2007.

Rëndësi e veçantë iu kushtua organizimit të konferencës së dytë të KGP që do të mbahet me 1 dhe 2 Shtator të këtij viti. Gjatë konferencës është paraparë që të ketë edhe aktivitete tjera, e njëra ndër to të jetë edhe një performansë artistike organizuar nga KGP.

Si tema kryesore për këtë konferencë u zgjodhen: Drejtësia tranzicionale, Gratë dhe Siguria si dhe Rrjetëzimi Horizontal i Koalicionit. Përfaqësueset e UNIFEM-it ofruan përkrahje gjatë takimit me idet pragmatike për të gjitha aktivitetet e KGP në të ardhmen.



Takimi i grupit strategjik të KGP me 29 mars, në Prishtinë.

Diplomojnë 20 Këshilltarë Psikosocial nga Kosova

One to One – Kosova organizoi ceremoninë e diplomimit të 20 këshilltarëve psikosocial nga Kosova që ndoqën programin e edukimit dy vjeçar.

Shërbimi i One to One filloi si shërbim për gratë dhe fëmijët e traumatizuar, por sot në qendrat e tyre ofrohen dhe përfitojnë shërbim psikosocial burra, gra, fëmijë, grupe të ndryshme pa dallime etnike, e gjithë kjo e mundur nga mbështetja financiare, morale dhe profesionale e One To One nga Britania e Madhe.

OJQ lokale One To One – Kosova pas tetë viteve përvojë pune dhe mundësi trajnimit për t'u zhvilluar, inicuan këtë shkollim, jo vetëm për anëtarët e saj por edhe të dhjetë pjesmarrësve të programit të trajnimit nga organizatat dhe institucionet tjera të Kosovës.

Për realizimin e gjithë kësaj u krijua komiteti drejtues i programit, u gjetën trajnerët më të përshatshëm për programin, u përpilua programi dhe orari i detajizuar dhe u nënshkrua MoU mes One To One-Britani e Madhe, Kosovës, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, Ministria e Arsimit shkencës dhe teknologjisë e Kosovës, Univerziteti i Prishtinës-Departamenti i psikologjisë, Univerziteti i Zagrebit dhe Shoqata për Ndihmë Psikologjike e Zagrebit. U përgjodhën pjesmarrësit me intervistë nga grupi intervistues dhe pas gjithë kësaj me 2 prill në Grand Hotel në Prishtinë u finalizua puna me ndarjen e diplomave.

Merita Halitaj, menaxherja e programit të kësaj qendre në fjalimin e saj gjatë ceremonisë së diplomimit tha: "Për tu zhvilluar diçka duhet filluar, e ne kemi filluar".

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

038 245 850

Hajdar Dushi C-2, II/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RrGGK

Igballe Rogova

Drejtoreshë Ekzekutive
igorogova@yahoo.com

Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit
cuca_fetahu@yahoo.com

Besa Shehu

Menaxhere e Financave
besa_shehu@yahoo.com

Alba Loxha

Marrëdhëniet me Publikun
albaloxha@yahoo.com

Bordi i RrGGK

Naxhije Buçinca
Delina Fico
Besim Kajtazi
Marte Prenkpalaj
Vjosa Dobruna
Belgjyza Muharremi
Behar Selimi

"Zëri i Gruas Kosovare"
është shkruar dhe dizajnuar nga
Alba Loxha,
me ndihmën e
Nicole Farnsworth.

www.womensnetwork.org

Fushata "Fillo luftën kundër kancerit të gjirit" organizuar nga Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit (QKLGJ) dhe RrGGK tani po vazhdon me fazën e dytë. Si pjesë e kësaj fushate me 8 mars, para Hotelit Grand u organizua nënshkrimi i peticionit për qytetarët, pastaj takimi me Ministrin e Shëndetësisë, debatet televizive dhe gjatë gjithë marsit është shfaqur TV spoti falas në tri kanalet televizive.

Me 16 prill në Prishtinë kjo qendër organizoi Konferencën për Kancerin e Gjirit ku morën pjesë ekspertë mjekësorë, përfaqësues të ministrive, të institucioneve të ndryshme, organizata si dhe paciente të mbijetuara.

Gjatë kësaj konference u prezantua gjendja shumë shqetësuese lidhur me sëmundjen e kancerit të gjirit në Kosovë, derisa kushtet e parandalimit, të zbulimit të hershëm dhe të trajtimit janë shumë të kufizuara.

Nafije Latifi, drejtoreshë ekzekutive e QKLGJ, në fjalën hyrëse tha se: "qëllimi i themeilit të Qendrës ishte informi-

mi i grave për sëmundjen dhe vetdijësi të tyre për kujdes më të madh për shëndetin e tyre, (me vetkontrolla dhe kontrolla të rregullta mjekësore), gjetja e mundësive të ndihmës për mbijetesë të grave të atakuara nga kjo sëmundje dhe e familjeve të tyre si dhe kërkesa për përkrahje adekuata institucionale dhe shëndetësore. Në vazhden e aktiviteteve të shumta të sensibilizimit të opinionit dhe të institucioneve përgjegjëse, të prezantimit dhe diskutimit të problemit të kancerit të gjirit në Kosovë, si dhe ngritjes së nevojës për hartimin e një strategjie kombëtare për luftimin e kësaj sëmundje, është edhe organizimi i kësaj Konference".

U bënë edhe prezantime nga aktiviste ekspert dhe shëndetësor.

Rekomandimet që dolën nga kjo konferencë janë: Zhvillimi i shërbimeve adekuata onkologjike në Kosovë; Fillimi i punës së Institutit Onkologjik; Kimioterapia, ter-



Qytetarët duke nënshkruar peticionin me 8 mars, para Hotelit Grand.

apia hormonale dhe Herceptina janë pjesë e listës esenciale të barërave; Të ngritet vetëdija e popullatës dhe politikëbërësve lidhur me rendësinë dhe seriozitetin e problemit; Avokimi dhe lobimi për problemin e kancerit të gjirit; Edukimi i profesionistëve për lëmitë përkatëse onkologjike, etj.

Gjatë muajve në vijim gjithashtu do të organizohen tryeza të rrumbullakëta nëpër komuna të ndryshme të Kosovës.

Trajtimi i Personave të Traumatizuar

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Luftës (QKRMT) e cila prioritet të saj ka ndihmën për mbijetues të torturës dhe gjetjen e mekanizmave për parandalimin e saj, gjatë muajit maj organizoi kursin me yoga terapi të quajtur "Terpia kognitive biheviorale". Përveç stafit të QKRMT pjesëmarrës të këtij kursi janë edhe profesionistë tjerë të kësaj lëmie si dhe studentë të psikologjisë dhe pjesëmarrës nga Shkupi dhe Kumanova.

Terpia kognitive biheviorale paraqet një ndër metodat më të aplikueshme për trajtimin e personave të traumatizuar. Si e tillë është dhënë rëndësi për organizimin e një kursi

afatgjatë/edukimi për fitimin e njohurive dhe aftësive për aplikimin e kësaj metode. Gjatë këtij kursi u diskutua për përvojat dhe praktikat, relaksim, teorinë e ndryshme, teknikat e frymëmarrjes, etj.

Një aktivitet tjetër i QKRMT-së është një trajnim dyditor, për torturën si dukuri negative që organizohet në bashkëpunim me Zyren për Qeverisje të mirë. Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin zyrtar të Njësisë për Drejta të Njeriut nëpër Ministrinë e Qeverisë së Kosovës.

Qëllimi i trajnimit është që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri nga kjo lëmi dhe të vetdijësohen me këtë dukuri negative dhe për mënyrat e parandalimit dhe luftimit të saj.

Njoftim i Shkurtër

Me 22 Maj 2007 Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport i Kuvendit të Kosovës organizoi një dëgjim publik ku ftoi tri OJQ në mesin e të cilave edhe Qendrën Kosovare për Studime Gjinore.

Luljeta Vuniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës prezantoi para Komisionit raportin "Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin e Arsimit" i botuar 2 muaj më parë, ku në mes tjerash tha: "Në mungesë të vlerësimeve dhe hulumtimeve lidhur me ecurinë e reformave në sistemin e arsimit të Kosovës, ka pak njohuri se deri ku është arritur me reformat në përgjithësi dhe në veçanti në aspektin gjinor, gjë cila ka qenë edhe subjekt i hulumtimit tonë".